



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 3244/2 Prot.

Vlorë më, 15.12.2025

VENDIM


Nr. 124, datë 15.12.2025

**PËR
RIHAPJEN E THIRRJES PËR VETKANDIDIM PËR ANËTARË TË
KOMITETIT TË ETIKËS NË KËRKIM
NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 80/ 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 19, të Statutit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, nenit 13 dhe 127 të Rregullores së Brendshme të UV-së, ligjit Nr. 8480, datë 27/05/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr. 824, datë 24/12./2021; si dhe referuar procesverbalit të komisionit ad-hoc me nr 3169/2 Prot., datë 10.12.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 15.12.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë rihapjen e thirrjes për vetkandidim, për 5 nga 7 anëtarët e Komitetit të Etikës në Kërkim në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, në periudhën **15.12.2025-28.12.2025**.
2. Anëtarët e përzgjedhur nga Senati Akademik për Komitetin e Etikës në Kërkim, sipas nenin 127 të Rregullores së UV-së, janë:
 - a) katër anëtarë – personel akademik me kohë të plotë, një nga çdo njësi kryesore,
 - b) një anëtarë – student, nga të gjitha njësitë kryesore.
3. Kriteret e kandidimit të personelit akademik:
 - niveli akademik: kategoria Profesor ose PhD
 - eksperiencia në kërkim shkencor: drejtues projekti kërkim-zhvillimi në minimumi 2 (dy) projekte UV ose 1 (një) projekt kombëtar.
4. Kriteret e kandidimit për anëtarin student:
 - cikli i studimeve: i dytë ose i tretë
 - nota mesatare e ciklit paraardhës të studimeve: minimalisht 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

- eksperiencia në kërkim shkencor: pjesëmarrës në një grup pune në projekt kërkim-zhvillimi ose autor i një teme diplome.
- 5. Pjesëmarrja në organe të tjera kolegjiale / detyra administrative nuk përbën pengesë për pjesëmarrje në Komitetin e Etikës në Kërkim.
- 6. Personeli akademik dhe studentët që duan të vetkandidojnë për anëtarë të Komitetit të Etikës në Kërkim dorëzojnë Formularin e Vetkandidimit në Zyrën e Protokollit në Rektorat. Në fund të periudhës së vet-kandidimit formularët dorëzohen në Senatin Akademik (sekretarja teknike) për ndjekjen e procedurave të mëtejshme.
- 7. Dy anëtarët e tjerë, Kryetari i Komitetit dhe Përgjegjësi i sektorit të Kërkimit shkencor dhe Projekteve, bëhen pjesë e Komitetit të Etikës në Kërkim si pasojë e detyrave funksionale që ushtrojnë në pozicionet administrative përkatëse.
- 8. Ky Vendim i njoftohet Dekanëve dhe sekretarive mësimore në cdo Njësie Kryesore.
- 9. Ngarkohet për zbatimin e këtij Vendimi Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike (Sektori i Burimeve Njerëzore) dhe Drejtoria e Kërkim-Zhvillimit dhe Marrdhënieve me të tretët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

FORMULAR VET-KANDIDIMI

PËR ANËTAR TË KOMITETIT TË ETIKËS NË KËRKIM
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

1. Të dhënat personale

- emri dhe mbiemri:
.....
- e-mail institucional:
.....
- numri i kontaktit:
.....

2. Pozicioni aktual në UV

- Njësia bazë:
.....
- Fakulteti:
.....

3. Të dhëna mbi kualifikimet dhe përvojën kërkimore

Për personelin akademik

(plotësohet nga kandidati akademik)

- Kategoria akademike: ☐ Profesor (Profesor Doktor, Profesor i asociuar) ☐ PhD
- Projekte kërkim-zhvillimi të drejtuara (vit, titulli, institucion financues):
 1.
 2.

(sipas kriterit: minimumi 2 projekte UV ose 1 projekt kombëtar)

Për kandidatin student

(plotësohet nga kandidati student)

- Cikli i studimeve: ☐ Master ☐ Doktoratë
- Nota mesatare e ciklit paraardhës:
.....
- Eksperienca në kërkim:
 - ☐ Pjesëmarrës në grup pune kërkimor
.....
 - ☐ Autor i teme diplome me karakter kërkimor
.....



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

5. Deklarata e kandidatit

Unë, në cilësinë e kandidatit për anëtar të Komitetit të Etikës në Kërkim, deklaroj se:

- Plotësoj të gjitha kriteret e përcaktuara në thirrjen për vetë-kandidim;
- Të dhënat e mësipërme janë të sakta;
- Jam i vetëdijshëm për përgjegjësitë që burojnë nga ky funksion.

Nënshkrimi i kandidatit: _____

Data: ____ / ____ / 2025